

# Treguesit demografikë


## Tremujori I – 2021

**Tiranë, më 12 maj 2021:** Numri i lindjeve për tremujorin e parë 2021 është 6.006, duke shënuar një rënie me 5,4 %, krahasuar me tremujorin e parë 2020.

Numri i vdekjeve për tremujorin e parë 2021 rezulton 9.657, duke shënuar një rritje prej 55,8 %, krahasuar me tremujorin e parë 2020.

Shtesa natyrore e popullsisë, diferenca midis lindjeve dhe vdekjeve në tremujorin e parë 2021, pësoi një rënie krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2020, nga 153 në -3.651 në 2021.

Fig. 1: Shtesa natyrore e popullsisë




\*\*Të dhëna paraprake

Në tremujorin e parë 2021, Kuksi është i vetmi qark i vendit që ka shënuar shtesë natyrore pozitive të popullsisë, ndërsa në qarqet e tjera, shtesa natyrore e popullsisë është negative.

Në tremujorin e parë 2021, vlera më e lartë e shtesës natyrore regjistrohet në qarkun e Kukësit, ku numri i lindjeve tejkalon me 10 numrin e vdekjeve, ndërsa ai më i vogël regjistrohet në qarkun e Tiranës, ku vdekjet tejkalojnë me 681 numrin e lindjeve.

Fig. 2: Lindjet, vdekjet dhe shtesa natyrore sipas qarkut, T1 – 2021\*\*



\*\*Të dhëna paraprake

### Lindjet

Në tremujorin e parë 2021, katër qarqe të vendit kanë shënuar rritje të numrit të lindjeve, ndërsa në tetë të tjerat numri i lindjeve është ulur, në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2020.

Në tremujorin e parë 2021, numri më i madh i lindjeve regjistrohet në qarkun e Tiranës, me 2.020 lindje, ndërsa ai më i vogël në qarkun e Gjirokastrës, me 113 lindje.

Rritjen më të madhe në përqindje të lindjeve, gjatë tremujorit të parë 2021, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2020, e zë qarku i Gjirokastrës, me 18,9 %.

Uljen më të madhe në përqindje të lindjeve, gjatë tremujorit të parë 2021, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2020, e zë qarku i Vlorës, me – 16,7 %.

**Tab. 1: Lindjet sipas qarkut**

Nr.	Qarku	I - 20	II - 20	III - 20	IV - 20	**I - 21
	<b>Shqipëria</b>	<b>6.351</b>	<b>6.706</b>	<b>8.007</b>	<b>7.011</b>	<b>6.006</b>
1	Berat	257	250	292	249	262
2	Dibër	311	390	451	389	360
3	Durrës	672	680	872	781	636
4	Elbasan	609	652	739	709	560
5	Fier	576	596	721	689	526
6	Gjirokastër	95	134	150	125	113
7	Korçë	391	454	482	369	357
8	Kukës	152	183	268	267	178
9	Lezhë	323	308	370	299	295
10	Shkodër	441	430	512	483	432
11	Tiranë	2.129	2.200	2.751	2.307	2.020
12	Vlorë	305	322	368	323	254
	<i>*Të panjohur</i>	90	107	31	21	13

*\*Kategoria "Të panjohur" nënkupton numrin e lindjeve të gjalla për të cilat informacioni i qarkut, ku është regjistruar lindja mungon.<sup>1</sup>*

*\*\*Të dhëna paraprake*

## Vdekjet

Në tremujorin e parë 2021, të gjitha qarqet e vendit kanë shënuar rritje të numrit të vdekjeve, në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2020.

Në tremujorin e parë 2021, numri më i vogël i vdekjeve regjistrohet në qarkun e Kukësit, me 168 vdekje, ndërsa ai më i madh në qarkun e Tiranës, me 2.701 vdekje.

Rritjen më të vogël në përqindje të vdekjeve, gjatë tremujorit të parë 2021 krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2020, e zë qarku i Korçës, me 11,5 %.

Rritjen më të madhe në përqindje të vdekjeve, gjatë tremujorit të parë 2021, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2020, e zë qarku i Tiranës, me 77,5 %.

<sup>1</sup> Shiko metodologjinë në linkun në vijim:

<http://www.instat.gov.al/al/temat/treguesit-demografik%C3%AB-dhe-social%C3%AB/lindjet-vdekjet-dhe-martesat/#tab4>

**Tab. 2: Vdekjet sipas qarkut**

Nr.	Qarku	I - 20	II - 20	III - 20	IV - 20	**I - 21
	<b>Shqipëria</b>	<b>6.198</b>	<b>5.386</b>	<b>6.624</b>	<b>9,397</b>	<b>9.657</b>
1	Berat	357	272	305	500	529
2	Dibër	236	214	281	307	370
3	Durrës	535	483	618	918	925
4	Elbasan	622	535	632	923	929
5	Fier	701	569	695	1,147	1.165
6	Gjirokastrë	217	188	212	297	281
7	Korçë	635	510	597	837	708
8	Kukës	137	138	153	199	168
9	Lezhë	286	271	326	423	433
10	Shkodër	486	457	618	781	637
11	Tiranë	1.522	1.339	1.764	2,504	2.701
12	Vlorë	463	408	414	558	805
	<i>*Të panjohur</i>	1	2	9	3	6

\*Kategoria "Të panjohur" nënkupton numrin e vdekjeve për të cilat informacioni i qarkut, ku është regjistruar vdekja mungon.

\*\*Të dhëna paraprake

# Metodologjia

Të dhënat tremujore për lindjet dhe vdekjet, në nivel kombëtar dhe qarku përbëjnë një hallkë të rëndësishme të demografisë së vendit. Ato paraqesin të dhëna mbi ndryshimet në popullsi, të cilat kanë impakt në jetën ekonomike dhe sociale të vendit. Këto të dhëna publikohen mbështetur në Programin e Statistikave Zyrtare 2017-2021.

## Lindjet

### *Të dhënat e lindjeve:*

Të dhënat e lindjeve, sipas gjinisë sigurohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, e cila dërgon në INSTAT vetëm numrin e lindjeve të banuesve në Shqipëri. Konsiderohen të gjitha lindjet e banuesve në Shqipëri gjatë periudhës referencë, duke mos marrë parasysh lindjet e banuesve jashtë Shqipërisë (emigrantëve), edhe pse mund të regjistrohen në zyrat e gjendjes civile, pranë ish-vendbanimeve të tyre.

### *Regjistrimet e vona të lindjeve*

Kryhet një rregullim i vogël i numrit të lindjeve që regjistrohen vonë për vitin aktual, në mënyrë që të përfshijmë të gjitha lindjet e ndodhura në periudhën referencë. Numri i lindjeve të regjistruara vonë nga viti i mëparshëm, janë konsideruar si një proxy për regjistrimet e vona të vitit aktual, duke konsideruar supozimin (si rezultat edhe i analizave tona të vazhdueshme) që numri i regjistrimeve të vona të lindjeve nuk ndryshon shumë nga viti në vit.

## Vdekjet

### *Të dhënat e vdekjeve*

Të dhënat e vdekjeve sigurohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, sipas karakteristikave bazë demografike. Konsiderohen të gjitha vdekjet e banuesve në Shqipëri gjatë periudhës referencë, duke mos marrë parasysh vdekjet e banuesve jashtë Shqipërisë (emigrantëve), edhe pse mund të regjistrohen në zyrat e gjendjes civile pranë ish-vendbanimeve të tyre.

### *Regjistrimet e vona të vdekjeve*

Bëjmë një rregullim të vogël të numrit të vdekjeve që regjistrohen vonë për vitin aktual, në mënyrë që të përfshijmë të gjitha vdekjet e ndodhura në periudhën referencë. Numri i vdekjeve të regjistruara vonë nga viti i mëparshëm, janë konsideruar si një proxy për regjistrimet e vona të vitit aktual, duke konsideruar supozimin (si rezultat edhe i analizave tona të vazhdueshme) që numri i regjistrimeve të vona të vdekjeve nuk ndryshon shumë nga viti në vit.

**Përkufizime:**

*Shtesa natyrore e popullsisë:* Shpreh rritjen/rënien e popullsisë, si rezultat i proceseve biologjike (lindjeve dhe vdekjeve) të saj, gjatë një periudhe kohe. Ky tregues shprehet si diferencë ndërmjet lindjeve dhe vdekjeve.

*Lindje e gjallë:* Lindjet e fëmijëve që shfaqën shenja jete.

*Vdekje:* Nënkupton zhdukjen e përhershme të të gjitha shenjave të jetës, në çdo kohë pasi ka ndodhur një lindje e gjallë (ndërprerjen e funksioneve vitale, pa aftësinë e ringjalljes).